



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 48-a, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21, 74/24) dhe pikës 21), paragrafi (3) të Vendimit për bonot e thesarit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 245/24), Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

U D H Ë Z I M

për shlyerje të transaksioneve me bono të emetuara të thesarit

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përshkruhet shlyerja e transaksioneve me bono të emetuara të thesarit (në tekstin në vijim: shlyerja).

II. PARIMET, PJSËMARRËSIT DHE UDHËZIMET PËR SHLYERJE

2. Shlyerja kryhet sipas parimit të "dorëzimit kundrejt pagesës".

Me përjashtim nga paragrafi (1) i kësaj pike, gjatë blerjes së bonove të thesarit në bazë të përkohshme nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (më tutje në tekst: Banka Popullore), për shkak të sigurimit të likuiditetit valutor në euro të bankave në bazë të linjës kreditore (repo) në euro të miratuar në Bankën Popullore nga Banka Qendrore Europiane, si dhe gjatë udhëheqjes së ekspozimit të transaksioneve repo, shlyerja kryhet sipas parimit "dorëzimi pa pagesë".

3. Pjesëmarrës në shlyerjen e transaksioneve me bonot e thesarit janë Banka Popullore dhe bankat, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret të cilat kanë të drejtë për pjesëmarrje në ankandet e bonove të thesarit.

Pjesëmarrësit paraqesin udhëzime për shlyerjen e transaksioneve të plota dhe transaksioneve repo me bono thesari në rolin e blerësit, respektivisht shitësit kur shlyen transaksion në emër të tij dhe për llogari të tyre ose në rolin e bankës së blerësit, respektivisht, bankës së shitësit kur shlyen transaksionet në emër të tyre, por në llogari të dikujt tjetër.

Te transaksionet repo, blerësi nga Marrëveshja e përgjithshme repo ose banka e blerësit dorëzon udhëzimet për shlyerje, në datën e blerjes si blerës i bonove të thesarit, ndërsa në datën e riblerjes si shitës i bonove të thesarit. Shitësi nga Marrëveshja e përgjithshme repo ose banka e shitësit, dorëzon udhëzimet për shlyerje, në datën e blerjes si shitës i bonove të thesarit, ndërsa në datën e riblerjes si blerës i bonove të thesarit.

4. Sistemet nëpërmjet të cilave kryhet shlyerja janë:

- Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë (në tekstin në vijim: MIPS), i cili si sistem pagesash mundëson transferimin e mjeteve ndërmjet pjesëmarrësve në atë sistem dhe siguron rrjedhjen e pandërprerë të porosive për transferimin e pronësisë së bonove të thesarit;

- Sistemi i kryqëzimit – siguron kryqëzimin e porosive të pranura nëpërmjet MIPS-it për transferim të pronësisë së bonove të thesarit;

- Regjistri i bonove të thesarit te Banka Popullore - siguron transferim të pronësisë së bonove të thesarit.

5. Shlyerja realizohet jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga dita e lidhjes së transaksionit. Në ditën e maturimit të bonove të thesarit nuk bëhet shlyerja e transaksioneve.

6. Pjesëmarrësit i paraqesin udhëzimet për shlyerjen:

- në formën e porosive të nënshkruara standarde në formë elektronike për transferimin e pronësisë, respektivisht për transferimin e mjeteve monetare, në pajtim me Standardin për qëllimet edhe formatin e porosive në Sistemin e kryqëzimit, dhe Standardin për qëllimet edhe formatin e porosive në MIPS, që është pjesë përbërëse e Udhëzuesit për zbatimin e rregullave për funksionimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë.

- nga momenti kur MIPS-i është në dispozicion të pjesëmarrësve për dërgimin e porosive për transferimin e mjeteve monetare deri në momentin kur MIPS-i e ndërpret marrjen e urdhëresave për transfertë në lidhje me aprovimin e kredisë njëditore në denarë, në pajtim me planin kohor të MIPS-it.

Gjatë blerjes së bonove të thesarit, blerësi ose banka e blerësit dërgon porosi për të transferuar mjete monetare nga llogaria e shlyerjes së blerësit ose nga llogaria e shlyerjes së bankës së blerësit në llogarinë e shlyerjes së shitësit ose në llogarinë e shlyerjes së bankës së shitësit. Porosia e transferimit të mjeteve monetare përmban fushën për kodin DVP në të cilin specifikohen udhëzimet për transferimin e pronësisë së bonove të thesarit. Gjatë zbatimit të parimit të "dërgesës pa pagesë", blerësi ose banka e blerësit në vend të porosisë për transferim të mjeteve monetare në MIPS, dorëzon porosi për transferimin e pronësisë së bonove të thesarit.

Gjatë shitjes së bonove të thesarit, shitësi dërgon porosi për transferim të pronësisë së bonove të thesarit deri te sistemi i kryqëzimit.

Pjesëmarrësit mund t'i tërheqin porositë për transferim të mjeteve monetare dhe porositë për transferim të pronësisë së bonove të thesarit para se të bëhet kryqëzimi i tyre.

7. Gjatë zbatimit të parimit "dorëzimi kundrejt pagesës", sistemi i kryqëzimit bën kontrollimin dhe krahasimin e elementeve të porosisë për transferim të mjeteve monetare (fusha për kodin për DVP) dhe porosisë për transferim të pronësisë së bonove të thesarit dhe raporton për gabimet që ndodhin.

Gjatë zbatimit të parimit të "dorëzimit pa pagesë", sistemi i kryqëzuar bën kontroll dhe krahason elementët e porosive për kalimin e pronësisë së bonove të thesarit dhe raporton çdo gabim që ndodh.

Kontrollimi dhe zbatimi i elementeve të porosive kryhet në pajtim me Standardin e qëllimit dhe të formatit të porosive në Sistemin e kryqëzimit.

8. Nëse nuk vjen deri te kryqëzimi i porosive nga pika 6), paragrafi (2) dhe (3) i këtij udhëzimi, deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në pikën 6), paragrafi (1), nënparagrafi (2) i këtij udhëzimi, porositë për transferim të pronësisë së bonove të thesarit llogariten si të

pavlefshme, ndërsa mjetet monetare i kthehen automatikisht blerësit ose bankës blerëse nga ana e sistemit për kryqëzim.

Në rast të gabimeve të ndodhura nga pika 7) e këtij udhëzimi dhe të porosive të pavlefshme nga paragrafi (1) i kësaj pike, vlerësohet se shlyerja nuk është realizuar dhe nuk ka pasoja për Bankën Popullore.

9. Nëse vjen deri te kryqëzimi i porosisë për transferim të mjeteve monetare dhe të porosisë për transferim të pronësisë së bonove të thesarit, Banka Popullore e kontrollon gjendjen e bonove të thesarit të shitësit në regjistrin. Nëse shitësi disponon me shumë të mjaftueshme të bonove të thesarit, Banka Popullore njëkohësisht bën transferimin e mjeteve monetare dhe pronësinë e bonove të thesarit.

Nëse shitësi nuk disponon me shumë të mjaftueshme të bonove të thesarit, shlyerja nuk është e realizuar dhe nuk ka pasoja për Bankën Popullore.

10. Blerësi ose banka e blerësit dhe shitësi ose banka e shitësit të bonove të thesarit raportohen për rezultatin e shlyerjes nëpërmjet sistemit për kryqëzim.

III. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

11. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-5650/4
19 Shkurt 2025
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit Ekzekutiv të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

